



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 506 Prot.

Tiranë, më datë 25.10.2024

VENDIM
Nr. 446, datë 25.10.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.10.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e projektit “Restaurimi i fasadës, rindërtimi i ‘Kafes së Madhe’ dhe ndërtimi i ambjentëve ndihmëse”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, Brenda Kufirit Qendër Historike Shkodër, me aplikues z. Bardhi Shllaku dhe zhvillues subjekti “XHENIS – SH”, me rekomandimin;
 - Subjekti zhvillues të sjellë kërkesë për rishikimin e emërimit të Pasurisë Kulturore “Kafa e Madhe”, shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë me Urdhër nr. 582 datë 25.09.2007 të M.T.K.R.S. dhe depozitimin e dokumentacionit teknik përkatës bazuar në gjendjen aktuale të konservimit, të hartuar nga një subjekt i licencuar në Restaurim;
- Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2 nga specialistët e DRTK Shkodër;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

